



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjjumit për Shërbime Publike

Prishtinë, 19 maj 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjjumit për Shërbime Publike

HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Shërbime Publike organizoi takimin e parë të këtij Kolegjiut me 19 maj 2011 (e enjte) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „Villa Gërmia” në Prishtinë.

Takimi kishte këtë rend të ditës:

- Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut,
- Përpilimi i Planit të Punës për vitin 2011,

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë e Shërbimeve Publike nga Komunitat e Kosovës, si dhe përfaqësues të AKK-së. Takimi u kryesua nga Ertan Munoglu, Menaxher i Programit në AKK dhe Agim Haziri, zv. Kryesues i Kolegjiut.

PËRMBLEDHJE

z. Munoglu – sqaroi se AKK ka organizuar dy takime me Kryesinë e Kolegjiut për shërbime publike mirëpo këto takime nuk janë mbajtur për shkak të mos prezencës së plotë të anëtarëve të Kryesisë. Si rrjedhojë (dhe në mungesë të Kryesuesit të kolegjiut) takimi i Kryesisë nuk ka mundur të zhvillojë dhe miratojë planin e punës për këtë vit. Prandaj është planifikuar zgjedhja e Kryesisë dhe Kryesuesit të ri, si dhe zhvillimi i planit të punës për vitin 2011.

z. Agim Haziri – shpjegoi rëndësinë e Kolegjiut në kuadër të AKK-së si avokues në interes të komunave. Përmes punës së përbashkët me AKK-në kemi ngritur zërin rreth problemeve të përbashkëta komunale. Gjatë takimit tonë do të diskutojmë edhe për jo efikasitetin e Kolegjiut, mungesën e bashkëpunimit, si dhe ku duhet bërë përmirësime për një punë më efektive në të ardhmen.

➤ **Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut**

z. Haziri –hapi diskutimin me pikat e rendit të ditës, duke informuar të pranishmit rreth përbërjes aktuale dhe paraqitjen e kandidaturave për pozitën e lirisë në Kryesinë të Kolegjiut.

z. Hysen Jerliu, Kamenicë – duke marrë parasysh problemin në SH. Publike do të ishte mirë të fuqizojmë rolin e Kolegjiut dhe punës së Kryesisë. Të deklarohen pjesëmarrësit në angazhimin e plotë në punën e Kryesisë dhe a do të jenë të gatshëm të marrin këto obligime. Nëse nuk janë të gatshëm për këtë punë është mirë të deklarohen e të mos figurojnë vetëm si emra në listë. Me këtë rast unë dua të propozoj

z. Haziri për Kryesues të ri të Kolegjiut.

z. Haziri – duke marrë parasysh vlerësimin e punës dhe angazhimit si një përgjegjësi në funksionimin sa më të mirë të punës unë do të jem i gatshëm për këtë detyrë të re.

z. Rasim Veseli, drejtor i shërbimeve publike, Mitrovicë – është mirë që të plotësohet Kryesia së pari e pastaj të procedojmë me zgjedhjen e Kryesuesit të ri.

z. Ibrahim Hyseni, drejtor i shërbimeve publike, Ferizaj – duhet të veprojmë sipas rregullores dhe rregullorja në zgjedhet e Kryesuesit.

z. Munoglu – do të ishte mirë që të deklarohen të gjithë ata persona të cilët janë të interesuar dhe të gatshëm të punojnë në Kryesinë e Kolegjiut.

z. Hasan Hasani, drejtor i shërbimeve publike, Prizren – deklaroi se për shkak të angazhimeve të mëdha do të ishte mirë që dikush tjetër të më zëvendësoj në Kryesi.

Lidhur më këtë pikë pati diskutime të shumta nga ana e pjesëmarrësve dhe përfundimisht u vendos për:

a. Ndryshimin e rregullores sa i përket numrit të anëtarëve në Kryesi – Kryesia u zgjerua nga 7 në 9 anëtarë të Kryesisë.

b. Anëtarët e Kryesisë të votuar me shumicën absolute janë zgjedhur:

1. z. Agim Haziri, Viti – Kryesues
2. z. Rushan Ceka, Kaçanik – zv. Kryesues
3. z. Zenel Kuqi, Junik
4. z. Agim Gashi, Prishtinë
5. z. Rasim Veseli, Mitrovicë
6. z. Sami Istrefi, Vushtrri
7. z. Përparim Krasniqi, Rahovec
8. z. Shemsi Maksuti, Skenderaj
9. z. Jovan sentić, Ranillug

➤ **Përpilimi i Planit të Punës për vitin 2011**

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës së Kolegjiut për shërbime publike për vitin 2011.

- **Funksionalizimi i Kolegjiut** duke pasur për objektivë kompletimin e kryesisë dhe efikasitetin e Kolegjiut.
- **Plotësimi i infrastrukturës ligjore** duke pasur për objektivë hartimin dhe harmonizimin e rregulloreve komunale si dhe hartimin dhe amendamentimin e ligjeve.

Për të zhvilluar më tej punën e Kolegjiut në objektivin e dytë (Plotësimi i infrastrukturës ligjore) Kolegjiut vendosi për formimin e katër Komisioneve profesionale në përbërje të:

Komisioni për transport publik:

1. Habib Qorri, Prishtinë - Kryesues

2. Arsim Aliu, Ferizaj
3. Fatmir Berisha, Gjakovë
4. Zekë Tejeci, Prizren
5. Xhemajledin Smaka, Mitrovicë

Komisioni për ruajtjen e ambientit dhe menaxhim të mbeturinave:

1. Hysen Jerliu, Kamenicë - Kryesues
2. Nazif Shala, Obilic
3. Afrim Ademi, Gjakovë
4. Skënder Rexhahmetaj, Deçan
5. Rufat Shkreta, Hani i Elezit

Komisioni për energji dhe efikasitet të energjisë:

1. Rasim Fejza, Podujevë - Kryesues
2. Shqipe Gashi, Vushtrri
3. Azem Mujku, Gjilan
4. Afrim Prokshi, Drenas
5. Miodrag Guzhvic, Partesh

Komisioni për menaxhim të ujit dhe kanalizimit:

1. Jovan Sentić, Ranillug - Kryesues
2. Fejzal Hoti, Prizren
3. Gëzim Shabani, Fushë Kosovë
4. Milaim Qeriqi, Lipjan
5. Shyhrete Peci, Mitrovicë

Në fund u caktua që takimi i radhës të mbahet me 05 korrik 2001. Po ashtu u kërkuar nga AKK të shpërndahet lista përfundimtare drejtorëve të shërbimeve publike për të konfirmuar pjesëmarrjen e përgjegjësve në Komisione.